



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

17 Janar, 2008

Të Nderuar Drejtorë të Kompanive të Ujit dhe Mbeturinave,

Siç e dini, Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina është rregullator ekonomik i kompanive të licencuara të ujit dhe mbeturinave në Kosovë. Qëllimi kryesor i rregullatorit është që të rregullojë Ndërmarrjet Publike në atë mënyrë që siguron ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme me çmim sa më të ulët për konsumatorin. Për të arritur këtë, rregullatori duhet të mbledh informacione relevante dhe **të besueshme** të ofruara nga kompanitë e ujit dhe mbeturinave për të marrë vendime rregullatore në pajtim me praktikën e mirë rregullatore.

Një nga aktivitetet kryesore të ZRRUM-it është monitorimi dhe publikimi i performancës (treguesve të punës) së kompanive të ujit dhe mbeturinave përmes Raporteve gjashtëmujore dhe Vjetore të Performancës. Qëllimi kryesor i këtyre raporteve është që tu ofrojë palëve të interesuara (përfshirë konsumatorët) informacione të plotë, konsistente dhe **të besueshme** mbi performancën aktuale të kompanive të licencuara në lidhje me aspektet operative, financiare, dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Përderisa përgjegjësia për raportimin e performancës kundrejt obligimeve të shërbimit qëndron tek kompanitë, ZRRUM-i është përgjegjës për vlerësimin e të dhënave të ofruara nga kompanitë në kontekst **të besueshmërisë së burimeve të të dhënave**, trendeve të zhvillimit, arritjeve të caqeve si dhe nxjerrjen e konkludimeve mbi performancën e përgjithshme të sektorëve të ujit dhe mbeturinave përfshirë vlerësimin e performancës krahasuese (d.m.th. 'benchmarking')

Ky proces ka filluar me 2007 kur, për herë të parë, ZRRUM-i ka publikuar Raportin Vjetor mbi Performancën e ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave për vitin 2006.

Me qëllim që Raporti gjashtëmujor dhe Vjetor i Performancës të bazohet **në informacionet e besueshme**, ZRRUM-i do të bëjë auditime/inspektime gjithëpërfshirëse dhe sistematike që përfshinë të dhënat operative, financiare dhe ato lidhur me shërbimet ndaj konsumatorëve që i raportohen ZRRUM-it çdo muaj nga kompanitë e ujit dhe mbeturinave, përmes procesit OFCR.

Procesi i rregullt vjetor i auditimit (kontrollit) do të bëhet nga ZRRUM-i një herë në vit (gjatë muajit Prill), që tani e tutje do të jetë aktivitet i rëndësishëm zyrtar dhe i rregullt. Përveç kësaj, ZRRUM-i do të bëjë auditim gjashtëmujor (në Korrik/Gusht) si dhe inspektim/auditim "ad-hok" të të dhënave relevante lidhur me çështjet specifike kurdo që konsideron se është e nevojshme për përmbushjen e përgjegjësisë të veta rregullatore.

Procesi i tërë i auditimit do të përkrahët nga projekti "WM-OFMP" i financuar nga SDC që do të ndihmojë zhvillimin e mëtejshëm të raportimit të performancës nga kompanitë.

Auditimi/inspektimi i të dhënave financiare dhe jo-financiare **nuk duhet të ngatërrohet** me çfarëdo auditimi tjetër që zhvillohet nga autoritetet tjera të vendit (p.sh. auditime financiare vjetore që bëhen në pajtim me SKK) që bëhet te kompanitë e ujit dhe mbeturinave.

Duke supozuar se qasja në të dhënat që do të auditohen me këtë proces është e gatshme dhe të dhënat janë të përgatitura mirë dhe të besueshme, ky proces i auditimit nuk do të duhet të paraqes ngarkesë shtesë për kompanitë. Në të vërtetë, kompanitë duhet të shfrytëzojnë sa më shumë të dhëna për qëllimet e veta dhe të sigurojnë se qasja në to është e lehtë arritshme, dhe të njëjtat janë të përgatitura mirë dhe të besueshme.

ZRRUM-i dëshiron të falënderojë singërisht të gjitha kompanitë për përgjigjet jashtëzakonisht pozitive ndaj kërkesave raportuese të ZRRUM-it në të kaluarën. ZRRUM-i dhe konsultantët presin një vazhdimësi të bashkëpunimit të ngushtë me kompanitë, edhe në të ardhmën.

Ne besojmë që kompanitë do të përkrahin plotësisht procesin e auditimit dhe të bashkëpunojnë me ekipin e auditimit. Ju lutem, vini re që përgjegjësia për pritjen dhe përkrahjen e ekipit të inspektimit të ZRRUM-it gjatë procesit të auditimit qëndron tek menaxhmenti i Kompanive, d.m.th. tek Drejtori Gjeneral dhe Drejtori Financiar.

Së shpejti ZRRUM do të kontaktojë secilën kompani lidhur me kohën e auditimit/inspektimit dhe kërkesat e përgjithshme për të dhënat, që do të jetë e përshtatshme për të dyja palët.

Ne do të vlerësojmë shumë nëse kompanitë e ujit dhe mbeturinave do të vazhdojnë ti përcjellin ZRRUM-it të dhëna të sigurta në kohë të duhur që është data 15-të e secilit muaj vijues.

Raportet e auditimit të përgatitura nga ZRRUM-i do t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe komenteve nga kompanitë e ujit dhe mbeturinave para se ZRRUM-i të bëjë finalizimin e tyre.

Raportet gjashtëmujore dhe vjetore të performancës të bëra nga ZRRUM-i do të përfshijnë përmbledhjen e procesit të auditimit siç është cekur më lartë përfshirë çfarëdo masa tjera të nevojshme nga kompanitë me qëllim të adresimit të lëshimeve ose gabimeve në aktivitetet e tyre të menaxhimit të të dhënave të paraqitura nga procesi i auditimit.

E mirëpresim bashkëpunimin tuaj,



Afrim Lajçi
Drejtor i ZRRUM-it